



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Doretuar Priljezon / Prilato Received / Delivered	21.12.2020	viti god year	2020
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Is Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	3248/2020		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.367/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj - anëtar, dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.367/2020 të datës 19.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED], me adresë rruga "Rizani", Nr.33, Lagjja Emshir, në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2020, mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.367/2020 e datës 19.11.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

### A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimit të datës 11.09.2019 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 18.09.2019 ka shpallur konkurs për rekrutimin e pozitës "Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës të Profesioneve të Lira", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja [REDACTED].

Me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Administratës Publike me datë 07.10.2019 ka njoftuar të gjitha institucionet publike për hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publik dhe ka udhëzuar që të gjitha procedurat e konkurseve të cilat janë shpallur sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të pezullohen përkohësisht.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 25.11.2019 është pezulluar me vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas vendosjes së masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Administratës Publike me datë 10.01.2020 ka lëshuar njoftim me shkrim dhe ka udhëzuar të gjitha institucionet publike që ti aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Drejtësisë ka vazhduar procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës të Profesioneve të Lira" ku ka themeluar Komisionin Përzgjedhës, ka organizuar testin me



shkrim, intervistën me gojë dhe në tërësi ka përfunduar procedurën e rekrutimit me datë 03.02.2020 përmes publikimit të njoftimit për kandidaten e suksesshëm [REDAKTUAR]

Me datë 18.02.2020 kandidati për punësim në pozitën "Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës të Profesioneve të Lira", z. [REDAKTUAR], ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë, me datë 28.02.2020 nxjerr vendimin me Nr.Prot.150/KA/02/2020, me të cilin e anulon konkursin për pozitën "Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës të Profesioneve të Lira".

Ministria e Drejtësisë përmes njoftimit të publikuar në webfaqen e Ministrisë së Drejtësisë ka njoftuar se ka anuluar konkursin e datës 19.09.2019, për pozitën "Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës të Profesioneve të Lira" me arsyetimin se: "Anulimi i këtij konkursi bëhet duke u bazuar në vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Nr.03-150/3 të datës 28.02.2020".

Kandidatja e përzgjedhur [REDAKTUAR], me datë 03.03.2020 ka parashtruar ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, respektivisht në Sekretariatën e Burimeve Njerëzore. Ministria e Drejtësisë me datë 12.03.2020 ju ka përgjigj ankueses në ankesën e datës 03.03.2020, duke theksuar që: "... Ju njoftojmë se komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Ministrinë e Drejtësisë është shkalla e parë e ankimit, ju mund të shfrytëzoni nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të vazhdoni me procedurat e mëtejme".

Ankuesja, më datë 19.11.2020 nëpërmjet e-mailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 19.11.2020 me Nr. Prot:2655/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2020, ankuesen e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Drejtësisë. Kjo e fundit më datë 08.12.2020 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2655/2020 të datës 19.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për përzgjedhje përfundimtare i datës 03.02.2020; Vendimi i KZKA-së i datës 28.02.2020 me nr.150KA/02/2020; Ankesa e ankueses drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, e datës 03.03.2020; Përgjigja e datës 12.03.2020 ndaj kërkesës së datës 03.03.2020; Emali zyrtar i datës 03.02.2020; Rekomandimi për emërim i datës 03.01.2020; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 31.01.2020; Pyetjet e komisionit përzgjedhës; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 31.01.2020; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Form.MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testi me shkrim i datës 27.01.2020 për kandidatët [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], Renditja përfundimtare e kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datë 22.01.2020; Raporti mbi përgatitjen e listës së shkurt i datës 22.01.2020; Kriteret e zgjedhjes së ngushtë; Vendimin me Nr.2/20 i datës 20.01.2020 për themelimin të komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Shkresë e datës 20.01.2020; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Kërkesa për punësim e kandidatës Uresa Restelica me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidatës [REDAKTUAR] me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidatës [REDAKTUAR] me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidatës Saniye [REDAKTUAR] me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidatit [REDAKTUAR]



me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidatës [redacted] me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidatit [redacted] me dokumentet e bashkangjitura; Konkursi i datës 18.09.2019;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se njoftimi për kandidaten e suksesshme për pozitën “Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë të Punës të Profesioneve të Lira” është publikuar më datë 03.02.2020, ndërsa më datë 28.02.2020 Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nxjerr vendimin me Nr.03-150/3 me të cilin ka anuluar konkursin e datës 18.09.2019. Kandidatja e përzgjedhur [redacted] me datë 03.03.2020 ka parashtruar ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, respektivisht në Sekretariatit e Burimeve Njerëzore. Ministria e Drejtësisë me datë 12.03.2020 ju ka përgjigjur ankueses në ankesën e datës 03.03.2020, duke theksuar që: “... Ju njoftojmë se komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Ministrinë e Drejtësisë është shkalla e parë e ankimimit, ju mund të shfrytëzoni nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të vazhdoni me procedurat e mëtejme”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke llogaritur afatet si më lart, konstaton se ankuesja ankesën me numër protokolli 2655/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ” si dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: “Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër A.nr.367/2020

Hysni Mustafa

*[Signature]*  
Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses [redacted]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

